



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit anonim, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në seancën e 47 të mbajtur me datë 31.03.2021 morri

#### VENDIM

Procedura për lëndën numër 09-694 me datë 27.02.2019, e formuar pas denoncimit nga parashtrues anonim me akuza për nepotizëm gjatë punësimit në shkollën e mesme komunale ..... dhe SHFK ..... në f. ...., NDËRPRITET.

Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit pas ndërmarrjes së aktiviteteve dhe sigurimit të dokumentacionit konstaton se akuzat nuk janë vërtetuar, kurse për shkak të ndryshimit të gjendjes faktike, gjegjësisht ndryshimit të personit përgjegjës në shkollë, Komisioni shtetëror nuk ka bazë për veprim të mëtutjeshëm kompetent në lëndën e përmendur.

Lënda me numër 09-694/1 me datë 27.02.2019, të mbyllet dhe të arkivohet.

#### SQARIM

Lënda me numër 09-694/1 me datë 27.02.2019 është e formuar në bazë të denoncimit anonim me akuza për nepotizëm, ndikim dhe parregullësi ligjore në procedurën për punësim në SHMK ..... në f. .... dhe SHFK ..... në f. ....

Me qëllim të përcaktimit të gjendjes faktike për lëndën e hapur, Komisioni shtetëror u drejtua deri tek shkollat e përmendura për dorëzim të dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës që janë në fuqi në vitin 2017 dhe 2018 dhe të gjitha ndryshimet në vitin 2019.
- Plani vjetor për punësime
- Emëri dhe mbiemri i të gjitha personave të punësuar në shkollë gjatë viteve 2017 – 2018
- Pasqyrë e plotësuar të personave të punësuar.

Nga personi përgjegjës ..... nga f. ...., Komisioni shtetëror i kërkoi edhe dokumentacionin për procedurën e punësimit të personave ....., ..... dhe ..... (pëlqim nga Ministria e finansave për miratim të mjeteve financiare për punësim, pëlqim nga Ministria e arsimit, konkursi i shpallur, listë e personave të paraqitur, rang listë nga kandidatët të paraqitur, vendim për zgjedhje të kandidatëve).

Nga dokumentacioni i dorëzuar, Komisioni shtetëror caktoi gjendjen faktike vijuese:

1. Gjatë realizimit të procedurës për punësim për plotësim të vendeve të punës me kuadër arsimore dhe joarsimore për vitin mësimor 2018/2019 në kohë të caktuar deri me datë 31.08.2019 për mësim në gjuhën shqipe, është shpallur Konkurs nr. .... me datë 14.01.2019. Konkursi i përmendur ka të bëjë me punësimin e nëntë ekzekutorëve dhe atë: një mësues për gjuhën gjermane, dy mësues për lëndën e fizikës, një mësues për gjuhë shqipe dhe literaturë, një mësues për gjuhë maqedone dhe literaturë, një mësues për sociologji, një mësues për gjuhë angleze, një mësues për kimi dhe një defektolog. Për të gjitha vendet e punës janë marrë

- pëlqime nga Ministria e arsimit dhe shkencës me mjete finansiare të siguruar për punësim të 11 personave në SHMK ..... në f. ...., finansim i vjetër, kurse Konkursi publik është i shpallur për punësim të 9 personave. Edhe pse është marrë pëlqim për punësim për mësues nga lënda e biznesit dhe sipërmarrësis dhe mësues për matematikë, të njëjtat pozicione nuk janë përfshirë me Konkursin publik nr. .... me datë 14.01.2019.
2. Për realizimin e procedurës për punësim sipas konkursit të përmendur është formuar komisioni për realizim të konkursit, në përbërje të tre anëtarëve: ....., ..... dhe ....., mirëpo nga dokumentat buron se procedura e realizuar për punësim, përmbanë nënshkrim nga vetëm një anëtar i komisionit, gjegjësisht personit ..... me çka vëhet në pikëpyetje validiteti i punës së komisionit.
  3. Nga analiza e dokumentacionit të dorëzuar, Komisioni shtetëror konstaton se, edhe pse me Konkursin publik me numër ..... me datë 14.01.2019 kërkohen nëntë ekzekutor, me Vendim me nr. 04-04/5 me datë 24.01.2019 miratuar nga drejtori i atëhershëm i shkollës, ....., janë pranuar 10 persona, gjegjësisht është pranuar mësues nga matematika, personi ....., edhe pse vendi i punës nuk është shpallur në konkursin e përmendur. Personi i përmendur sipas të dhënave të marra nga shkolla ka të kryer shkollën e mesme.
  4. Më pastaj, nga dokumentacioni i dorëzuar konstatohet se për arkatarë të SHMK ..... në f. ...., është i emëruar personi ..... me fakultet ekonomik, kurse në aktin e sistematizimit kërkohet me shkollë të lartë ose të mesme për atë vend të punës.
  5. Personi ..... i punësuar në SHMK ..... është i punësuar si mësues nga lënda e sportit dhe aktiviteteve sportive me shkollë të mesme edhe pse është e nevojshme shkollimi i lartë. Komisioni shtetëror posedon të dhëna se personi ka diplomë për mbarim të shkollimit të lartë nr. ...., dhënë nga Akademia ....., por e njëjta në procedurë gjysqore është e shpallur si e falsifikuar.
  6. Në aktin e sistematizimit të SHMK ....., në fshatin Likovë në pjesën e shërbimit ndihmës-technik, për vendin e punës pastrues, si ekzekutorë janë paraparë katër persona, kurse sipas pasqyrës së plotësuar të të punësuarve të dorëzuar nga shkolla, shihet se janë punësuar gjashtë persona, që don të thotë se ka numër më të madh të të punësuar, në kundërshtim me aktin e sistematizimit.

Për njohje më detale me gjendjen në shkollë dhe punësimet e realizuara KSHPK lëshoi thirrje për takim me drejtorin ....., drejtor i SHMK ..... Me datë 02.07.2019 në hapsirat e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit është mbajtur takim në të cilin drejtori dha sqarimin e vet për procedurën e realizuar për punësim dhe arsyetim për gjendjen e treguar nga KSHPK si veprime joligjore: procesverbale të pa nënshkruara, më tepër të punësuar, arsim joadekuat.

Të pakënaqur nga sqarimet e dhëna, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit dorëzoi kërkesë deri tek Inspektorati shtetëror i arsimit si kompetent për veprim dhe ai bëri inspektim mbi realizimin e procedurës për punësim pas konkursit publik me nr. .... me datë 14.01.2019 në SHMK ..... në f. ...., dhe veçanërisht të vërtetohet gjendja e gjitha gjatë pikave të shënuara më sipër: të rishikohet validiteti i dokumentave nga komisioni për zgjedhje sipas konkursit publik; angazhimi i ..... si mësues i matematikës pa konkurs publik; emërimi i personit ..... për arkatarë në shkollën e njëjtë; të rishikohet procedura për punësim të personit ..... në vendin e punës mësues nga lënda e sportit

dhe aktiviteteteve sportive, në lidhje me atë se vallë personi i përmendur i plotëson kushtet e përcaktuara me ligj në pikëpamje të arsimit të cilin e posedon, për vendin e cekut të punës, të rishikohet procedura për punësim në vendin e punë pastrues në shkollën e përmendur.

Nga ana e Inspektoratit shtetëror të arsimit është dorëzuar informim për inspektimin e jashtëzakonshëm të bërë në SHMK ..... dhe në lidhje me kërkesën e lëndës, janë vërtetuar gjendjet faktike vijuese:

- Në lidhje me gjendjen se janë kërkuar njëmbëdhjet pëlqime, kurse konkursi i shpallur është për dhjetë persona është konstatuar se me datë 14.01.2019 është shpallur konkurs për nëntë persona, kurse për mësues për matematikë është shpallur konkur i veçantë me datë 17.01.2019;
- Punësimi i mësuesit për orë nga biznesi dhe sipërmarrësia nuk është nëpërmjet konkursit me arsye që të njëjtat iu janë shpërndarë mësuesve me arsim adekuat, të cilët vetëmse kanë qenë të punësuar në kohë të pacaktuar në shkollë;
- Në lidhje me procesverbalin e Komisionit për realizim të konkursit të përmendur dhe mosnënshkrimin nga të gjithë anëtarët e komisionit, Inspektorati ka vërtetuar se i njëjti është nënshkruar nga të gjithë anëtarët, edhe pse në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar me të cilin disponon Komisioni shtetëror gjendja nuk është e njëjtë.
- Në lidhje me punësimin e personit ..... i angazhuar në vendin e punës për lëndën e matematikës, me konkurs të veçantë me datë 17.01.2019 me arsim joadekuat, Inspektorati shtetëror ka konstatuar se gjatë kohës së shpalljes së konkursit, personi ..... ka pasur Vërtetim nga Fakulteti i shkencave natyrore pran Universitetit shtetëror të Tetovës nr. .... me datë 06.09.2017, për provime të kaluara dhe 182 kredi të fituara. Personi ..... ka fituar titullim Profesor i diplomuar për matematikë me datë 16.07.2020, gjegjësisht 15 muaj pas angazhimit të tij në SHMK ..... në f. ....
- Për zgjedhje të personit ..... për arkatarë në shkollën e njëjtë, nga Inspektorati konstatohet se personi ..... ka konkuruar dhe është pranuar në vendin e punës arkatarë me dëftesë për të kryer shkollim të mesëm ashtu siç është paraparë në Aktin për sistematizim dhe konkursit publik.
- Në lidhje me kërkesën që të kontrollohet se vallë personi ..... si mësues për sport dhe aktivitete sportive i punësuar me diplomë nga Akademia ..... është vërtetuar se personi i angazhuar si mësues për sport dhe aktivitete sportive me Kontratë në vepër me datë 29.10.2018, kurse në dosjen e personit të përmendur ka vetëm diplomë nga Kolegji Univeristeti në ....., ku ka marrë shkallën Baçellor për shkencë nga edukata fizike, sport dhe rekreacion me 180 ektc me datë 04.02.2019, për të njëjtën diplomë ka Aktvendim për pranim të kualifikimit për arsim të lartë jashta vendit, nënshkruar nga Ministri për arsim. Në dosje theksohet se prsoni i përmendur nuk ka diplomë tjetër.
- Për gjendjen me numër më të madhë të pastruesve në lidhje me numrin e paraparë me sistematizim të vendeve të punës Inspektorati shtetëror i arsimit vërtetoi se në nenin 3 të rregullores për ndryshime dhe plotësime të rregullores për sistematizim të vendeve të punës për vendin e punës 35 – pastrus, në lidhje me numrin e ekzekutorëve nga 4 rritet në 6. Komisioni shtetëror nuk disponon me këto ndryshime të rregullores për sistematizim të vendeve të punës, edhe pse kanë qenë kërkuar të gjitha ndryshimet e sistematizimit.

Në bazë të inspektimit të jashtëzakonshëm të bërë në SHMK ..... në f. ...., Inspektorati shtetëror i arsimit nuk ka konstatuar shkelje të cilat janë në kompetenca të tij.

Pas kontrollimit të sistemit distribues të Regjistrir qendror të RMV është vërtetuar se personi ..... nuk e kryen më funksionin e drejtorit në SHMK ..... në f. ....

Nga dokumentacioni i dorëzuar, Komisioni shtetëror vërtetoi se nuk ka elemente të mjaftueshme për ngritje të procedurës për vërtetim të gjendjes së konfliktit të interesave, në përputhje me nenin 76 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të ndërtesave, gjegjësisht nuk janë vërtetuar akuza të cilat udhëzojnë në kryerje të njëanshme të autorizimit publik dhe obligimit nga persona zyrtarë në SHMK ..... dhe SHFK ..... në f. ....

Pas veprimit të Inspektoratit shtetëror të arsimit për lëndën konkrete dhe në lidhje me të shënuarën më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave.

KOMISIONI SHTETËROР ПЁР  
PARANDALIM ТЁ КОРРУПСИОНИТ  
Kryetarë: Biljana Ivanovska

Pas përfundimit të KSHPK  
Përpunoi: S. M., këshilltarë  
Miratoi: K. H, anëtarë i KSHPK